



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr.____ / 2026

PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10/2023, “PËR
INFORMACIONIN E KLASIFIKUAR”¹**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 81, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I:

Në ligjin nr.10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 4, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 4, ndryshohet si më poshtë vijon:

“4. “Autoritet klasifikues” janë Presidenti i Republikës, Kryeministri dhe titullarët e institucioneve, që në përmbushje të detyrave funksionale, me autorizim të Kryeministrit, fitojnë të drejtën për klasifikimin e informacionit.”.

¹ Ky projektligj është përafshuar pjesërisht me:

- Vendimin e Këshillit të datës 23 shtator 2013 “Mbi rregullat e sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të BE-së” (2013/488 / BE). Nr. CELEX 32013D0488, Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian seria L, nr. 274, datë 15.12.2013, faqe 1-50;
- Direktivën 2009/81/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit datë 13 korrik 2009 “Mbi koordinimin e procedurave dhe dhënien e disa kontratave për punë, furnizime dhe shërbime nga autoritetet kontraktore apo ente në fushat e mbrojtjes dhe sigurisë dhe që ndryshon direktivat 2004/17/KE dhe 2004/18/KE”, të ndryshuar, Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian seria L, nr. 216/76, datë 20.08.2009, faqe 1-76.

2. Pika 11, ndryshohet si më poshtë vijon:

“11. Informacion i klasifikuar “Sekret shtetëror” është çdo informacion ose material, pavarësisht nga forma, natyra ose mënyra e transmetimit të tij, i përgatitur ose që përgatitet, të cilit i është vendosur një nivel i caktuar klasifikimi dhe afat ruajtjeje klasifikimi në përputhje me këtë ligj, në interes të sigurisë kombëtare dhe mbrohet nga shkatërrimi, humbja, vjedhja, rrjedhja, përhapja e paautorizuar ose qasja nga çdolloj tjetër komprometimi sigurie.”.

Neni 2

Në nenin 12, pas pikës 2, shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. “Përrjashtimisht, në raste të veçanta dhe me afat të kufizuar, funksionari i lartë i një institucioni që prodhon informacion të klasifikuar mund ta ushtrojë të drejtën e “Autoritetit klasifikues”, vetëm më miratim të Kryeministrit pas kërkesës së arsyetuar të titullarit të institucionit nëpërmjet AKSIK. Afati përacaktohet në autorizim. Në këtë rast AKSIK-u i kthen përgjigje institucionit brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike. Rregulla të detajuara për zbatimin e kësaj pike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 3

Në nenin 17, bëhen këto ndryshime:

1. fjala “dokument” zëvendësohet me “informacion”;
2. togfjalëshi “niveLIN e klsifikimit”, zëvendësohet me “niveLIN dhe afatin e ruajtjes së klasifikimit.”.

Neni 4

Në nenin 22, pas pikës 6, shtohet pika 6/1, me këtë përmbajtje:

“6/1. “Në mënyrë përjashtimore, kanë të drejtën e deklasifikimit të një informacioni të klasifikuar, pa qenë autoritet klasifikues, ato institucione që prodhojnë një informacion të klasifikuar, në përgjigje të informacioneve të administruara nga institucione të tjera.”.

Neni 5

Në nenin 38, pas pikës 2, shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, në rastet e gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme, të fatkeqësive natyrore dhe të emergjencave të tjera civile, në pamundësi të evakuimit të informacionit të klasifikuar me urdhër të titullarit të përfaqësisë, vendoset shkatërrimi emergjent i tij.”.

Neni 6

Shkronja “j”, e nenit 64, ndryshohet si më poshtë vijon:

“j) kryen trajnime të vazhdueshme për personelin që punon me informacion të klasifikuar në zbatim të rregullave, të cilat përcaktohen në rregulloren që miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 7

Në nenin 70, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2, ndryshohet si më poshtë vijon:

“2.b Inspektimet kryhen duke respektuar parimet e pavarësisë së inspektimit, proporcionalitetit në veprimtarinë e inspektimit dhe programimit të inspektimeve.”.

2. Pika 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

“4. Rregullat e detajuara për kryerjen e procedurave të inspektimeve, konstatimit, shqyrtimit, ankimit dhe ekzekutimit të kundërvajtjeve administrative, përcaktohen në rregulloren, që miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 8

Në nenin 75, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “e”, e pikës 3, ndryshohet si më poshtë vijon:

“e) shkelja e rregullave për transportimin fizik të informacionit të klasifikuar;”.

2. Pas pikës 7, shtohet shtohet pika 7/1, me këtë përmbajtje:

“7/1. “Vendimi për kundërvajtjen administrative, i vendosur nga AKSIK përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutimi i këtij vendimi bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.”.

Neni 9

Në pikën 2 të nenit 76, pas shkronjës “dh” shtohet shkronja “e”.

Neni 10

Neni 78, ndryshohet si më poshtë vijon:

Neni 78

Shqyrtimi dhe ankimi i kundërvajtjeve administrative

1. Kundërvajtjet administrative konstatohen nga trupa e inspektimit në AKSIK sipas rregullave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave në zbatim të pikës 4, të nenit 70 të këtij ligji.
2. Pranë AKSIK ngrihet dhe funksionon struktura përgjegjëse për shqyrtimin e ankimit kundër aktit të konstatimit të trupës së inspektimit sipas rregullave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave në zbatim të pikës 4, të nenit 70 të këtij ligji.
3. Personi, ndaj të cilit është vendosur masë administrative, sipas dispozitave të këtij ligji, ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatën kompetente sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 11

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 2, 6 dhe 7 të këtij ligji.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYETARI

Niko PELESHI